

Për: Qeverinë e Republikës së Kosovës
Z.Hashim Thaqi-Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës
Z.Bujar Bukoshi-Zv.Kryeministër-Kryesues i Task Forcës së Ujërave
Z.Besim Beqaj / Ministër-Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Z.Dardan Gashi / Ministër-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Bordin e zyrës rregullatore të energjisë – ZRRE
Z.Ali Hamiti, Kryesues i Bordit-ZRRE
Departamenti i tarifave dhe çmimeve-ZRRE

Z.Fadil Çitaku, Kryesues i Bordit të KEK-ut
Z.Arben Gjukaj, Drejtor Menaxhues-KEK

782112
30.01.12

Cc.: Z.Nait Hasani, Kryetar i Komisioni për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Z.Ramadan Sejdiu
Njësia për Politika dhe Monitorim NP-MZHE

Bordevë të Drejtorëve të Kompanive Rajonale të Ujësjellësve

Z.Baton Begolli-Këshilltar Task Forca e Ujërave

Nga: Bordi i Drejtorëve të Shoqatës së Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës “SHUKOS”

Lënda: REAGIM I KOMPANIVE REGJIONALE TË UJËSJELLËSVE PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NDAJ INICIATIVAVE PËR NGRITJEN E TARIFAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Kompanitë Regjionale të Ujësjellës Kanalizimeve veprimtarin e tyre e konsistojnë në furnizimin me ujë të pijes të popullatës si dhe kujdesin e funksionimit normal të infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit .

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kompanitë po përballen me vështirësi të shumta në afarizmin e tyre dhe në përmbushjen e misionit që kanë për furnizim me ujë të pijes për klientelen dhe më gjerë. Peshë e veçantë për funksionimin normal të Kompanive të Ujësjellësve bartë energjia elektrike dhe furnizimi i rregullt me energji elektrike si burim i vetëm në funksionimin e infrastrukturës teknologjike të pajisjeve dhe stabilimenteve për trajtim dhe pompim të ujit.

Ngritja e vazhdueshme dhe rapide e çmimit të energjisë elektrike nga ZRRE në raport me çmimin e ujit nga ZRRUM-i krijoi disharmoni dhe vështirësi të theksuar në rentabilitetin dhe afarizmin e kompanive ujore. Informata e fundit nga mediet dhe nga ZRRE për kërkesën e KEK-ut për ngritje të sërishme të çmimit të energjisë elektrike paraqet edhe një shqetësim serioz për Kompanitë Regjionale të Ujësjellësve i cili cenon afarizmin e planifikuar në Planet e Biznesit për katër vitet e ardhme.

203

Prandaj bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-185 Për Rregullatorin e Energjisë, se të gjitha autoritetet Publike obligohen të bashkëpunojnë me Zyrën e Rregullatorit për të mundësuar ushtrimin e

funksioneve dhe detyrave të saj, dhe se Zyra e Rregullatorit gjatë ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të saj duhet të bashkëpunoj me persona apo organizata që përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e konsumatorëve. Grupi punues (GP) për energji elektrike në kuadër të SHUKOS-it i mbledhur më dt. 19.01.2012 pas shqyrtimit të shumë probleme aktuale me të cilat përballen Ujësjetësit që determinohen nga çështjet e energjisë elektrike seriozisht reagon kundër një veprimi të ngritjes së çmimit të energjisë elektrike pa pëlqimin e kompanive të Ujësjetësve.

Bazuar në nenin 14 të Ligjit Mbi Rregullatorin e Energjisë, kompetencat që i jep këtij autoriteti ligji si organ i pavarur i Republikës së Kosovës ; Të përgatis metodologjinë tarifore si dhe të monitoroj metodologjinë tarifore pika 2.4 , të nxjerr rregulla për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve pika 2.13, të nxjerr rregulla dhe vendime individuale në harmoni me ligjin pika 2.16 , GP i bënë kërkesë këtij autoriteti si dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik- Qeverisë së Republikës së Kosovës si Aksionar, që për Kompanitë Regjionale të Ujësjetësve për shkak të misionit që kanë në furnizimin me ujë të pijes të popullatës së Kosovës, të aprovohet një status special i cili përcakton rëndësinë strategjike të Kompanive të Ujësjetësve në funksionimin e shtet formimit të Republikës së Kosovës. Trajtimi i Impianteve dhe Objekteve trajtuese të Ujësjetësve si **Objekte strategjike të Shtetit të Kosovës** e ka rëndësinë e vet në ngritjen e mirëqenies dhe funksionimit normal të jetës së qytetarëve të Kosovës. Në kuadër të trajtimit si **Objekte strategjike** Kontratat e Ujësjetësve me KEK-un do të duhej të sjellin favore si në furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike ashtu edhe në çmimin e volitshëm të energjisë elektrike për Kompanitë Regjionale të Ujësjetësve.

Si u lartë shënuar stacionet pompuese zakonisht kanë shpenzim linear energjetik dhe fuqia e angazhuar e njehsuar nga maxigrafët me çmim mjaftë të lartë duke përfshirë energjinë aktive e reaktive të faturuar, paraqet komponentin tjetër shumë domethënëse. Sipas të dhënave që disponojmë nga vendet në rajon por edhe më gjerë kjo ngarkesë është zvogëluar dukshëm për të shtuar se në disa shtete është mënjanuar plotësisht nga faturimi ndërsa faturat e energjisë elektrike për ujësjetësit publik mbulohen në tërësi nga buxheti Qeveritar-Shqipëria e pjesërisht Maqedoni.

Aktualisht jemi në fazën e riprocedimit të kërkesave tashmë të plasura dhe të njohura për shumë çështje të kësaj natyre e mos të flasim për fuqinë e angazhuar – maksigrafin që presim të mënjanohet tërësisht nga faturat elektrike prandaj tendenca për ngritje të sërishme të çmimeve është lajm shumë i keq që e rëndon edhe më tej situatën financiare të KRU-ve. Gjithashtu është edhe në interes të KEK-ut që ky grup i konsumatorëve që është pagues i rregullt dhe që merr pjesë në një përqindje të dukshme në tërë konsumin energjetik të Kosovës të mbetet financiarisht i “shëndosh” për ti paguar obligimet ndaj KEK-ut.

Ngritjet e vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike, kostoja aktuale apo çdo ngritje në të ardhmen do të paraqesin shqetësim serioz të mbijetesës së Kompanive Rajonale të Ujit (KRU) respektivisht sigurimit të shërbimeve të ujit për konsumatorët.

SHUKOS me mbështetjen e plotë të anëtarëve përkatësisht trupave tjerë /GP-se do të jetë në gatishmëri të plotë për të ofruar mundësi dhe rrugëzgjidhje me qëllim që ndërmarrjet publike të ujësjetësve të punojnë më mirë në interes të përmbushjes së misionit të tyre.

SHUKOS
Msc.Nadire Bejtullahu Vitija
Drejtor Menaxhues



SHUKOS
Kryetari i Bordit
Z.Besim Baraliu
KE,KRU “Hidroregjionijugor”
Prizren

Adresa: Rr.Bill Klinton nr 13, Prishtinë, Kosove
Tel/fax: +381 38 526 873; Mob: +377 44 182 497,
E-mail: shukos2001@yahoo.com
Web:www.shukos.net